



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 26, datë 28.02.2022**

**PËR**

**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN NR. 48, DATË 30.06.2015 “PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE AFATET E LICENCIMIT SI DHE RASTET E REFUZIMIT TË LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BROKERIMI NË SIGURIME”, E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e një ndryshimi në Rregulloren nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar, si më poshtë:**

Pika 2, e nenit 13, ndryshon si vijon:

*“2. Autoriteti nëse vëren mangësi apo pasaktësi në dokumentacionin e paraqitur, apo nëse e gjykon të nevojshme, njofton kërkuuesin për miratim/licencim për plotësimin e tyre brenda një afati 30 ditor. Ky afat mund të zgjatet edhe me 30 ditë të tjera për arsye të justifikuara. Nëse pas përfundimit të afatit, nuk plotësohet dokumentacioni, shqyrtimi i kërkesës/aplikimit ndërpritet. Në rast riaplikimi, dokumentacioni duhet të depozitohet nga e para.”*

- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**  
**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin METE**